



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1441, datë 04.11. 2010

Për

Mbylljen e procedimit administrativë të filluar me Vendimin nr. 1352, datë 06.08.2010 të KD të AKEP “Për moslidhje marrëveshje interkoneksioni midis Mobitel WLC sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 04.11.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Mbylljen e procedimit administrativeë të filluar me Vendimin nr. 1352, datë 06.08.2010 të KD të AKEP “Për moslidhje marrëveshje interkoneksioni midis Mobitel WLC sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projektakti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, pretendimet**):

BAZA LIGJORE :

1. Neni 120 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 66-104 e vijues te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

3. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin e miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010 e ndryshuar;
4. Rregullore per Proçedurat e Zgjidhjes së Momarrëveshjeve e miratuar me VKD nr. 1296, date 11.06.2010;
5. Oferte Referencë e Interkoneksionit për AMC;
6. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (***Rregullorja e Brendshme***), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1352, datë 06.08.2010 i KD të AKEP “Për fillimin e procedimit administrativ per zgjidhjen e mosmarreveshjes per moslidhje marrëveshje interkoneksioni midis Mobitel WLC sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”;
2. Shkresë e AKEP nr. 2596/4 prot, datë 11.08.2010 “Njoftim Vendimi nr.1352 datë 06.08.2010 të KD të AKEP”, drejtuar sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a”;
3. Shkresë e AKEP nr. 2596/4 prot, datë 11.08.2010 “Njoftim Vendimi nr.1352 datë 06.08.2010 të KD të AKEP”, drejtuar sipërmarrësit Mobitel WLC sh.a”;
4. Shkresë Mobitel WLC nr. 51 Prot, datë 18.08.2010 (AKEP: nr. 2596/6 prot, datë 23.08.2010) “Dërgohen pretendimet dhe provat shkresore të Mobitel WLC sh.a në zbatim të Vendimit të AKEP nr. 1352, datë 06.08.2010”. Bashkëlidhur korrespondenca shkresore e Mobitel WLC me AMC;
5. Shkresë e AMC nr. 1937/5 datë 19.08.2010 (AKEP: 2596/5 Prot, datë 19.08.2010) “Përgjigje mbi kërkesën e Vendimit nr. 1352 mbi fillimin e procedimit administrativ për kompaninë Mobitel WLC”. Bashkëlidhur korrespondenca me email dhe shkresore e AMC me Mobitel WLC;
6. Shkresë e AKEP me nr. 3053 prot, datë 29.09.2010 “Njoftim për seancë dëgjimore”
7. Shkresë e AKEP me nr.3053/2 prot, datë 11.10.2010 “Njoftim për seancë dëgjimore”
8. Seanca dëgjimore e zhvilluar më datë 15.10.2010 në selinë e AKEP midis palëve,
si dhe
9. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen,
10. Bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se:

I. Mbi detyrat e lëna për sipërmarrësit, mbi depozitimin e pretendimeve me shkrim deri më 20.08.2010, bazuar në pikën 3 të Vendimit nr. 1352, datë 06.08.2010, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarreveshjes për moslidhje MI midis Mobitel WLC sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a.” , sqarojnë si më poshtë vijon:

1. AMC sh.a me shkresën nr. 1937/5 Prot, datë 19.08.2010 (AKEP: 2596/5 Prot, datë 19.08.2010) “Përgjigje mbi kërkesën e Vendimit nr. 1352 mbi fillimin e procedimit administrativ për kompaninë Mobitel WLC” shpjegon se:

AMC ka patur një marreveshje interkoneksioni me lidhje direkte me Mobitel WLC duke filluar nga viti 2004. Implementimi i kesaj marreveshje eshte bere me kerkesen e Mobitel WLC dhe AMC ka paguar ½ e investimit per t’i ofruar mundesine shoqerisë Mobitel WLC per tu lidhur direkt. Ne shkurt te vitit 2009 AMC përditësoi të gjitha kontratat e interkoneksionit direkt me shoqeritë e ndryshme duke zbatuar te gjithe bazen e re të RIO, e implementuar ne bazë të urdherit AKEP. Interkoneksioni i realizuar midis AMC dhe Mobitel WLC, dhe skema e konfigurimit te interkoneksionit, sipas AMC është e ndermjetme dhe në bazë të termave të RIO. AMC ofroi tarifimin e tij. Gjatë kesaj periudhe janë organizuar takime me punonjësit dhe me juristet e Mobitel WLC, gjithashtu, në veçanti është organizuar dhe një takim ne ambjentet e AMC me Z. Nobert Wieser (CEO i Kompanisë MobitelWLC) ne gusht te vitit 2009. Përfaqësuesi i Mobitel WLS ka konfirmuar se nuk eshte i interesuar te mbaj lidhje direkte me kosto të lartë për trafikun aktual të cilin e terminon në rrjetin e AMC;

Sipas AMC, Mobitel WLC duke u bazuar në strategjine për kostot, e pa të arsyeshme të ndërprese lidhjen direkte dhe të kaloje trafikun e saj ne rrjetin e AMC nepermjet Altelecom sh.a dhe nuk është AMC-ja që ka nderprere marreveshjen e interkoneksionit me Mobitel WLC;

Me anë të shkreses të dates 29.09.2009 dërguar AMC, Mobitel WLC konfirmoi propozimin per tranzitim te thirrjeve nga Altelecom sh.a drejt AMC. Me daten 07.10.2009 Mobitel WLC ka derguar kërkesë AMC për implementimin e numeracionit të tyre nepermjet Altelecom sh.a;

Me shkresën nr.1637 prot. date 18.03.2010 dërguar AMC, Mobitel WLC konfirmon se ka nderprere lidhjen direkte ne zbatim të kushteve të RIO;

AMC sqaron se Mobitel WLC nuk ka bër njoftim per të bërë ivestimin me FO per tu lidhur direkt me AMC ne PIO-e në Laprakë. Investimi i bërë nga Mobitel WLC është i pa rëne dakord me parë me AMC për një menyre të re të lidhjes direkte të interkoneksionit;

Sipas AMC, në përgjigje te kërkesave te Mobitel WLC dërguar në AMC për rilidhje te marrëveshjes interkoneksionit, ne ambjentet e AMC jane organizuar dy takime. Ne takimin e dates 30.04.2010 është bërë me dije se ishte vendimi i Mobitel WLC të nderpriste lidhjen direkte me AMC dhe ta kalonte me tranzitim nga Altelecom sh.a, njëkohesisht perfaqesuesi i Mobitel WLC u

informua se situata teknike e kapaciteteve te AMC kishte ndryshuar, kapacitete te cilat per momentin jane te kufizuara dhe qe jane krijuar per shkak te një upgrade te gjërë te switche-ve te AMC, i cili është i domosdoshem për dy arsye:

- a. Centralet e AMC (MSC-s) jane ne operim qe nga viti 2000, pra i perkasin nje teknologjie te vjeteruar qe për këtë arsye lejon interkoneksion vetem me E1 dhe jo STM, FO etj
- b. Meqënëse jemi perpara zhvillimeve të reja siç janë Portabiliteti i Numrit dhe 3G, ky upgrade që përmendëm më sipër bëhet akoma më i domosdoshëm për të përgatitur infrastrukturen e rrjetit tonë për të qenë e gatshme të suportoje keto teknologji të reja. Ky proces kërkon kohë sipas AMC,

AMC bën me dije se në takimin e organizuar me Mobitel WLC te cituar me lart u diskutua dhe ankesa e Mobilel WLC per cilesin e sherbimit për thirrjet e abonenteve te Mobitel WLC të terminuar në rrjetin AMC. U shpjegua se kjo vinte për shkak te problemeve te shkaktuara nga operatorët e tjere me trafik me volume te medha dhe me CLI të modifikuar. Për këtë problem u punua ngushtesisht me Albtelecom dhe parametrat cilësore u normalizuan brenda kufijëve të lejuar;

Në përfundim të pretendimeve AMC shpreh qëndrimin se, pretendimet e Mobitel WLC për shkelje të kuadrit rregullator nga ana e AMC nuk qëndrojnë;

AMC si prove dokumentacioni për pretendimet e sipercituara bashkangjitur ka depozituar shkresen nr. 2596/5, datë 19.08.2010, drejtuar AKEP-it, ka derguar e-mail dhe fax-et e derguara Mobitel WLC si dhe shkresat e Mobitel WLC derguar AMC. Dokumentacioni eshte i fotokopjuar nga AMC.

2. Mobitel WLC me shkresën nr. 51 datë 18.08.2010 (AKEP: nr. 2596/6 prot, datë 23.08.2010) “Dërgohen pretendimet dhe provat shkresore të Mobitel WLC sh.a në zbatim të Vendimit të AKEP nr. 1352, datë 06.08.2010” s’qaron se:
 - a. Mobitel WLC është pajisur me license nga AKEP për ofrimin e shërbimit publik telefonik fiks në disa komuna dhe bashki te vendit. Me hyrjen ne fuqi te ligjit nr. 9918 dt. 19.05.2008, Mobitel WLC i’u nënshtrua regjimit të autorizimit të Përgjithshëm;
 - b. Mobitel WLC me shkresen nr. 2596 prot, datë 8.07.2010 i është drejtuar AKEP me ankesën për të zgjidhur mosmarreveshjen mes palëve për moslidhjen e MI-se, duke filluar një procedim administrativë nga AKEP, për urdhërimin e Albanian Mobile Communications sh.a (ne vijim AMC) për të lidhur marreveshje interkoneksioni me Mobitel WLC, duke vënë në dispozicion të AKEP gjithë informacionin në lidhje me korespodencën e shkresave me AMC si më poshtë vijon:
 - Shkrese e Mobitel WLC extra prot , datë 18.03.2010 ;
 - Vijuar me shkresen nr. 18 prot, datë 02.04.2010;

- Shkresë e Mobitel WLC extra prot, date 19.05.2010;
 - Vijuar me shkresën nr. 34 prot, date 10.06.2010;
- c. Prej vitit 2004 deri në Nentor të vitit 2009 Mobitel WLC dhe AMC sh.a kanë patur një marrëveshje interkoneksioni funksionale dhe kanë respektuar kushtet e saj, sipas Mobitel WLC në vitin 2009, AMC sh.a ka nderprerë marrëveshjen e interkoneksionit me Mobitel WLC pas një kushtëzimi finaciare kundrejt Mobitel WLC, “Tarifë për marrëveshjen e interkoneksionit” me vlerën 190 000 lekë në muaj. Mobitel WLC tarifën e AMC sh.a e vlerëson të pabazuar ligjërisht dhe në kundërshtim me RIO-on e AMC sh.a të miratuar nga AKEP;

d. Mobitel WLC sqaron se në kushtet kur:

- AMC sh.a nuk ka kthyer përgjigje të shkresave të Mobitel WLC, nuk ka shfaqur gadishmeri dhe nuk është ulur në tryezë bisedimesh për të rilidhur interkoneksionin;
- Nuk ka asnjë ndryshim në marrëdhëniet mes AMC sh.a dhe Mobitel WLC pas ankimit në AKEP;
- Nuk ka asnjë ndryshim të fakteve të paraqitura më parë nga Mobitel WLC në AKEP;
- Me VKD nr. 1345, date 23.07.2010, AKEP ka detyruar AMC sh.a të japë interkoneksion;
- Kërkesa e Mobitel WLC drejtuar AMC sh.a është e bazuar në ligj dhe në rregulloret e AKEP,

kërkon nga AKEP konform legjislacionit në fuqi të dalë me vendim detyrues ndaj AMC sh.a për të rilidhur interkoneksionin me Mobitel WLC;

Bashkangjitur me shkresën nr.51, datë 18.08.2010, mbi depozitimin e pretendimeve të sipërcituara, Mobitel WLC ka depozituar korrespondencën shkresore si më poshtë vijon:

- Shkresë e Mobitel WLS extra prot, datë 18.03.2010 ;
- Shkresë e Mobitel WLS nr. 18 prot, datë 02.04.2010 ;
- Shkresë e Mobitel WLS extra prot, datë 19.05.2010;
- Shkresë e Mobitel WLS nr. 34 prot, datë 10.06.2010;
- Shkresë e Mobitel WLS nr. 46 prot, datë 27.07.2010,

II. Për sa më sipër si dhe nga seanca dëgjimore midis palëve Këshilli Drejtues konstaton se:

1. Mobitel WLC dhe AMC konfirmojnë se marrëveshja e Interkoneksionit midis tyre, prej vitit 2004 deri në Nentor të vitit 2009 ka qënë me radio rele dhe secila palë ka paguar pjesën e vet duke përgjysmuar investimin e kryer nga të dyja palët;
2. Në shkurt të vitit 2009 AMC përditësoi të gjitha kontratat e interkoneksionit direkt me operatorë të ndryshëm në zbatim të bazës së re të RIO. Në kuadër të këtyre ndryshimeve AMC vendos një tarifë

mujore te cilen e arsytet me kostot qe perllongarit qofte edhe ndaj Mobitel WLC për shërbimet e lidhjes, tarifë e cila për Mobitel WLC ishte e papranueshme dhe ne kete menyre vendos të shkëpusë lidhjen me AMC duke tranzituar thirrjet nëpërmjet Albtelecom.

3. AMC si subjekt i detyrimit per akses dhe interkoneksion refuzon lidhjen me Fibër Optike për shkak të kufizimit në kapacitete dhe pamundësisë teknike për lidhje direkte dhe lëshimin e E1.
4. Për sa më sipër AKEP, vlerëson se Operatori ofrues i interkoneksionit AMC, detyrohet të ofrojë akses për interkoneksion per palet perfituese ndersa kur nuk ekzistojnë mundësitë teknike, por në zbatim edhe të pikës 4 të nenit 6 të Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit miratuar nga AKEP me VKD nr.1300 datë 14.06.2010, e ndryshuar:

“Operatori ofrues, në rastet kur refuzon t’i sigurojë operatorit përfitues shërbimet e specifikuara në ofertën referencë dhe e motivon këtë refuzim me mungesën e mundësive teknike, ai ka detyrimin t’i paraqesë operatorit përfitues një shpjegim gjithëpërfshirës të arsyeve të refuzimit dhe të specifikojë afatin kohor të saktë në të cilin kërkesa do të përmbushet. Kur operatori ofrues refuzon të sigurojë shërbimet e specifikuara në ofertën referencë për operatorin përfitues për shkak të kriterëve të tjera të përmendura në pikën 2 të këtij neni, operatori ofrues duhet, gjithashtu, të specifikojë kushtet që duhet të plotësojë operatorin përfitues me qëllim që operatorin ofrues të jetë në gjendje të përmbushë kërkesën. Për secilin rast të specifikuar në këtë paragraf, kur operatorin ofrues paraqet shpjegime për operatorin përfitues, kopje të këtyre shpjegimeve i depozitohen njëkohësisht dhe AKEP-it”.

Sa më sipër, edhe në rast të vërtetimit të pamundësisë teknike të AMC, shpjegimi i dhënë nga AMC nuk ka përfshirë afatin kohor të saktë se kur mund të përmbushet kërkesa si dhe kur do të jetë i mundur realizimi i interkoneksionit direkt apo përfundimi i punimeve në rrjet, çka është në kundërshtim me rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit;

5. AMC ka detyrimin të sigurojë lidhjen e pikës së interkoneksionit me centralin e interkoneksionit me kapacitetet dhe portat e nevojshme E1,
6. AKEP bazuar në kapacitetet teknike, menaxheriale dhe ekonomike të AMC, gjykon si të arsyeshme dhe ligjore lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit midis AMC dhe Mobitel WLC sipas parashikimeve në Aneksin V të Marrëveshjeve të lidhura me palët e tjera, brënda 30 ditësh nga data e publikimit të Vendimit në faqen e Internetit të AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 140 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S :

1. Të mbyllë procedimin administrativë të filluar me VKD nr. 1352, datë 06.08.2010 për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për moslidhje marrëveshje interkoneksioni midis Mobitel WLC sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”;
2. Operatori ofrues Albanian Mobile Communications sh.a të lidhë marrëveshje interkoneksioni me operatorin përfitues Mobitel WLC sh.a sipas përcaktimeve të Urdhërit bashkëngjitur, brënda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi;
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë :

1. Alketa MUKAVELATI

2. Benon PALOKA

3. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURÇE